



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK**

PROJEKT –VENDIM

NR____, DATË __/__/2026

PËR

**MIRATIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS “ARTUR BUJARI” ME VENDNDODHJE:
NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL, BASHKIA Durrës.**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” i ndryshuar, Ligji nr.114/2015 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 475 datë 23.12.2017 “Për miratimin e sistemit të ri të adresave të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e emërimit të rrugës “Artur Bujari” me vendndodhje: Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, sipas planvendosjes bashkëngjitur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit dhe Ndërmarrja Rruga, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

**DREJTORIA ARSIM, KULTURË, RINI
SPORTE DHE KOM.FETARE**

**Drejtore
Migena Muhaj**

**DREJTORIA LIGJORE
Drejtore**

Alneida Rroshi

KRYETARI E BASHKISË

Emiriana Sako



DURRES
DURRES

DURRES DURRES

DURRES DURRES

DURRES DURRES

DURRES DURRES

DURRES DURRES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E ARSIM, KULTURË, RINI, SPORTE DHE
KOMUNITETE FETARE
SEKTORI I KULTURËS

KËSHILLIT BASHKIAK
RELACION

PËR

MIRATIMIN E EMËRTIMIT RRUGËS ME EMRIN “ARTUR BUJARI”

Të nderuar Këshilltarë!

Drejtoria e Arsim, Kulturë, Sport, Rini, Kom. Fetare, nisur nga kërkesa e ardhur nga Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë Durrës, në të cilën kërkohet emërtimi i një rruge në Njësinë Administrative Rrashbull me emërtimin Rruga “Artur Bujari”, ju relaton propozimin si më poshtë vijon:

Artur Bujari lindi në Durrës në vitin 1956 në një familje të njohur për kohën.

Mbaroi studimet e mesme profesionale në shkollën “Industriale” dhe duke qenë se ishte i apasionuar pas detit filloi punë në oficinën e Flotës Detare. Më pas vazhdon studimet e larta universitare. Pas studimeve të larta rikthehet në Flotën Detare dhe punon deri në vitin 1993.

Në prill të vitit 1993 krijon shoqërinë Italo – Shqiptare “Buna” e cila merrej me prodhimin e kolltuqeve dhe dyshekëve, duke u bërë një nga të parët prodhues në vend. Arturi anëtarësohet në Dhomën e Tregëtisë dhe Industrisë në Durrës dhe kontribuon në zgjerimin dhe fuqizimin e saj ndër vite. Në qershor të vitit 2014 atij i akordohet nga Bashkia Durrës titulli “Qytetar Nderi i Durrësit” me motivacionin: “Për kontributin e rëndësishëm që jep në zhvillimin ekonomik të qytetit, në mbështetjen e aktiviteteve, në promovimin e historisë dhe kulturës qytetare Durrëse”. Në gusht 2015 ai zgjidhet N/ Kryetar i Këshillit Bashkiak Durrës, detyrë që e kreu me shumë përgjegjësi duke mbrojtur interesat e qytetarëve dhe të qytetit. Gjatë kësaj periudhe ai kontribuoi në binjakëzimin me Bashkinë e Bitontos në Bari të Italisë, duke merituar edhe Titullin: “Qytetar Nderi” i Bitontos.

Në 13 mars 2024 Artur Bujari ndron jetë si pasojë e një sëmundje të zemrës.

Për të nderuar figurën e tij (pas vdekjes), i kërkojmë Këshillit Bashkiak vendosjen e emrit të tij rrugës të sipërpërmendur e cila ndodhet në Njësinë Administrative Rrashbull. Rruga e propozuar e ka pikënisjen nga rruga “Orion” deri tek rruga “Idriz Xhafi”.

Bashkëlidhur është kërkesa e ardhur nga Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë Durrës, si dhe harta me rrugën përkatëse.

DREJTORE

Arsim, Kulture, Sport, Rini, Kom. Fetare

Migena Muhaj





Lënda : Propozim për emërtimin e një Rruge në Territorin e Bashkisë Durrës

Drejtuar: Bashkisë Durrës
Këshillit Bashkiak Durrës

02.03.26 3006

Në Vëmendje të: Znj. Emiriana Saka, Kryetare e Bashkisë

Durrës

E nderuar Kryetare e Bashkisë,
Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Durrës përfiton nga rasti për t'ju uruar suksese e mbarësi në drejtimin dhe menaxhimin e Institucionit Tuaj.

Me anë të kësaj shkrese Ju paraqesim një kërkesë për vlerësimin e figurës së të ndjerit **Z. Artur Bujari** duke emërtuar Rrugën tek Agroturizmi "Pema e Jetës" me emrin e tij.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Durrës e çmon tejmasë dhe është falenderuese për kontributin që Z. Artur Bujari ka dhënë ndër vite si antar i Asamblesë dhe Kryesisë së Dhomës në mbështetje të saj. Me aktivitetin e tij si Përfaqësues i Shoqërisë "**BUNA**" **SHPK** të themeluar që në vitin 1996, me një eksperiencë të gjatë në fushën e prodhimit e tregtimit në industrinë e mobilimit, ka përfaqësuar denjësisht sektorin e "Prodhimit" në Dhomën tonë.

Emërtimi i kësaj rruge në emrin e tij do të shërbejë jo vetëm për nderimin dhe lartësimin e vlerave më të mira qytetare që Zoti Bujari përçonte, por edhe për përfaqësimin dinjitoz të një brezi të tërë biznesmenësh që përballuan cdo sfidë dhe hodhën themelet në fuqizimin e biznesit dhe në zhvillimit ekonomik të Qytetit tonë. Emri i Artur Bujarit qëndron në plejadën e biznesmenëve të nderuar të Durrësit.

Besojmë në vlerësimin Tuaj për miratimin e emërimit të kësaj Rruge "Artur Bujari" në nderim dhe vlerësim për këtë figurë të rëndësishme të biznesit durrësak.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

Me respekt
Kryetari
Neritan Golja

